

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-9865-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	"InfraCore SH.P.K"
NUI	812169523
Adresa	Drenas
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	049571977
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Brentian Mala
Adresa elektronike	infracoreshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	03.11.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

29.10.2025 - Njoftim per Kontrat

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7

Neni 27

Neni 59

Neni 65

Neni 61

Neni 108/A

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

1. Kërkesa për standardin ISO 39001:2015 – Nuk lidhet me objektin e kontratës dhe

punës.

2. Kufizime të panevojshme në peshën e makinerive – Intervalet e ngushta për eskavator, grejder dhe cilindër nuk kanë bazë teknike.

3. Makineri sheshuese/niveluese me librezë qarkullimi – Kërkesë e gabuar, sepse këto makineri nuk regjistrohen për qarkullim publik.

4. Dumper dhe cilindër vibrues me peshë fikse – Kërkesë joproporcionale; performanca nuk varet nga pesha e saktë.

5. Kërkesa për kontrata të ngjashme = 250,000 € – Jopërpjesëtimore me vlerën aktuale të kontratës.

Kriteret në tërësi janë diskriminuese dhe joproporcionale – Në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë.

Duke u mbështetur në analizën e fakteve të lartcekura dhe në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (i ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092), si dhe në Rregulloren Nr. 001/2021 të KRPP-së, vlerësojmë se disa prej kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit nuk janë në përputhje me parimet themelore të konkurrencës së drejtë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Këto specifikime teknike dhe administrative, në formën aktuale, kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve potencialë dhe nuk janë të domosdoshme për sigurimin e cilësisë së zbatimit të kontratës. Për rrjedhojë, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të ndërmarrë rishqyrtimin e plotë të dosjes së tenderit, me qëllim që të:

1. Eliminohet kriteret dhe kërkesat që nuk qëndrojnë në raport proporcional me qëllimin dhe vlerën e kontratës;

2. Harmonizohet të gjitha specifikimet teknike dhe njësitë e matjes me legjislacionin në fuqi;

3. Riformulojë kriteret e kualifikimit në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrje e gjerë dhe konkurrencë e ndershme;

4. Sigurojë zbatim të drejtë të nenit 27, 59 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik.

Nëse Autoriteti Kontraktues **nuk ndërmerr masa për rishqyrtimin e dosjes brenda afatit ligjor ne si Operator Ekonomik jemi të detyruar që lëndën ta adresojmë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP),**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Na pamundësohet pjesëmarrja e barabartë në procedurën e prokurimit për shkak të kriterëve dhe specifikimeve diskriminuese të vendosura në dosjen e tenderit.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*